

PËRKUJTIMI I TË RËNËVE

Kryebashkiaku Xhelal Mziu, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit



FAQE 4

INVESTIMI

Realizohet një tjetër projekt për banorët e Paskuqanit, rruga "Ismail Qemali"



FAQE 7

SPORT

Kamza, një "supermaci" ndaj Skënderbeut



FAQE 8

FESTAT E NËNTORIT

Zhvillohet festivali i shkollave 9-vjeçare në Pallatin e Kulturës Kamëz



FAQE 8



Gazetë e Bashkisë Kamëz
KAMZA

E përdyjavshme
Nr. 208 Nëntor 2017
Çmimi 20 lekë
drmediakamez@gmail.com
www.kamza.gov.al

Kongresi ballkanik mbi mjedisin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve
Kryebashkiaku Mziu: Qeveria të ndihmojë për ndërtimin e landfilleve apo impianteve

FAQE 2

Në 28 nëntor 1944, Shqipëria, nga një pushtim i vjetër në një pushtim të ri!

Faqe 4-5

Qendra për Çështje të Informimit Publik INFOÇIP vlerëson transparencën në Bashkinë Kamëz

Faqe 3

22 nëntori 1908 - Kur Kongresi i Manastirit përcaktonte alfabetin e gjuhës shqipe

Faqe 6

Bashkia dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu vazhdojnë mbështetjen e plotë ndaj ekipit KF Kamza

Faqe 8



Bashkia Kamëz vlerësohet me rezultate maksimale për luftën ndaj korrupsionit

FAQE 3



NË BRENDËSI

Investimet në Paskuqan, më të mëdha se në 27 vitet e fundit

FAQE 7

Ndërmarrja e Ujësjetës-Kanalizimeve, ftesë bashkëpunimi në kuadër të reformës së ujit

FAQE 2

Kryebashkiaku Mziu inspekton një ndër investimet e vitit 2017, rrugën "Ajet Xhindoli" në lagjen Paskuqan 2, Vresht

FAQE 7

Bashkia Kamëz, pjesëmarrëse në projektin e BE-së "Bashkitë për në Evropë"

FAQE 3

FK Kamza: Arbitri na vodhi fitoren e merituar, i njëjti që gjykoj edhe në Kukës, këmbana bie për FSHF-në

FAQE 8



Kryebashkiaku Mziu në kongresin për mbetje: Qeveria të ndihmojë për ndërtimin e landfilleve apo impianteve bashkëkohore

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ishte i pranishëm në “Kongresin ballkanik për zgjidhjen e mbetjeve”, gjatë të cilit mbajti edhe një fjalë përpara pjesëmarrëse.

Në fjalën e tij, z. Mziu ngrii disa shqetësime për sa i përket çështjes së mbetjeve urbane, që përbën një problem për gjithë vendin. Ndër të tjera ai tha se mjaft bashki nuk e kanë mundësinë e zgjidhjes së këtij fenomeni, konkretisht të transportit të mbetjeve, sepse kërkohet një kosto shtesë, e jashtëzakonshme, e cila rëndon mbi buxhetin e bashkive.

Një problem tjetër që ngrii kreu i Bashkisë Kamëz ishte ai i mbledhjes së detyrimeve apo tarifave, fenomen që vihet re në çdo bashki, duke mos arritur të mbledhin ato detyrime e pagesa të nevojshme, kështu që, sipas z. Mziu, duhet gjetur një kuadër ligjor për një harmonizim, në mënyrë që të mblidhen këto tarifa dhe, për rrjedhojë, do të ketë një tjetër situatë.

Edhe kompetencat e pushtetit vendor përbëjnë një shqetësim tjetër, sipas kryebashkiakut Mziu, sepse bashkitë nuk kanë një autonomi të plotë, ashtu siç paraqitet gjendja edhe për sa i përket dhënies së lejeve mjedisore. Në këtë aspekt, duhet pasur më shumë autonomi pushteti vendor, sepse askush, më shumë se bashkitë, nuk është i interesuar për ta zgjidhur çdo rast dhe çdo situatë në të mirë të bashkisë, qytetit apo qytetarëve.



“Përveç bashkive, të cilat në buxhetin e tyre duhet patjetër të kenë një zë dhe një dysheme të nivelit të buxhetit të tyre për sa u përket mbetjeve urbane, edhe pushteti qendror duhet të ndihmojë në këtë situatë ku ndodhet sot Shqipëria, për ndërtimin e landfilleve apo impianteve bashkëkohore, të cilat mund të jenë pjesë e financimit, por edhe e hartimit të projekteve të huaja. Unë përfaqësoj një nga bashkitë që kanë përfituar nga fondet “IPA Adriatic” në lidhje me përpunimin e mbetjeve urbane ose me blerjen e makinerive apo kontejnerëve, ku kemi aplikuar. Jam i sigurt që Shqipëria është e fundit në Evropë për sa i përket përfitimit të fondeve të Bashkimit Evropian, të cilat

jepen në këtë fushë të rëndësishme dhe duhet gjetur një zgjidhje midis qeverisë, midis bashkive, si dhe organizatave jofitimprurëse të fokusuara në këtë drejtim për të aplikuar dhe për të përfituar nga këto fonde. Besoj që është një moment i duhur dhe le të shërbejë ky kongres si një impuls më shumë për qeverinë, për kryetarët e bashkive, por edhe faktorë të tjerë për të gjetur një zgjidhje për ta bërë Shqipërinë më të pastër sesa sot”, - e mbylli fjalën e tij z. Mziu.

“Kongresi ballkanik mbi mjedisin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve” ishte pjesë e panairit të përvitshëm të Klik Ekspo Group. Kongresi ishte një bashkëpunim mes Klik Ekspo Group si dhe shoqërisë

“Le të shërbejë ky kongres si një impuls më shumë për qeverinë, për kryetarët e bashkive, por edhe faktorë të tjerë për të gjetur një zgjidhje për ta bërë Shqipërinë më të pastër sesa sot”

civile, i cili synonte të orientonte pushtetin vendor dhe atë qendror në menaxhimin e integruar të mbetjeve. Kongresi erdhi në një kohë kur çështjet më të diskutuara globalisht janë problemet e mjedisit, ngrohja globale, menaxhimi i mbetjeve dhe zgjidhjet teknologjike përkatëse, zhvillimi i qëndrueshëm, shtimi i sipërfaqeve të gjelbra, kursimi dhe mirëmenaxhimi i rezervave natyrore, të qenët miqësorë me mjedisin në industri e bizneset që ushtrojnë veprimtari të ndjeshme ndaj mjedisit.

Ndërmarrja e Ujësllës-Kanalizimeve, ftesë bashkëpunimi në kuadër të reformës së ujit



Ndërmarrja e Ujësllës-Kanalizimeve në Bashkinë Kamëz u ka bërë thirrje qytetarëve për bashkëpunim në kuadër të reformës së ujit. Ndërmarrja e Ujësllës-Kanalizimeve fton qytetarët dhe bizneset që të përfitojnë nga hapësira kohore prezantuar nga qeveria për të vetërregulluar situatën dhe marrëdhënien me ujësllësin sipas platformës së prezantuar për të gjitha kategoritë e klientëve.

VETËRREGULLIM

Klientë me kontratë pa matës

Aplikim pranë Ndërmarrjes së Ujësllës-Kanalizimeve Kamëz për pajisjen me matës duke u paraqitur pranë sporteveleve tona:

- Bashkia Kamëz (arka UKK)
- Njësia Administrative Bathore (arka UKK)
- Njësia Administrative Paskuqan (arka UKK)

Pas bërjes së pagesës për matës, Ndërmarrja UKK menjëherë do të marrë masa për vendosjen e matësit të certifikuar.

Klientët me situatë debitore dhe marrëdhënie jokorrekte në pagesë

Afati kohor sipas udhëzimit 6.11.2017 për vetërregullim të debisë është deri më datë 30.1.2018, pas kalimit të këtij afati, penalitete dhe masa të ashpra sipas ligjit për administrimin dhe furnizimin me ujë. Ne bëjmë me dije se klientët e kësaj kategorie mund të paraqiten brenda këtij afati për të lidhur një aktmarrëveshje, ku termat e lidhjes së kësaj marrëveshje janë: 25% e totalit të debisë paguhet në momentin e nënshkrimit dhe pjesa tjetër e ndarë në 12 muaj dhe këst me bazë mujore, plus faturën e konsumit mujor faktik.

Klientë me lidhje të paligjshme

Afati për vetërregullimin deri më 30.1.2018.

Paraqituni pranë ndërmarrjes së UK Kamëz dhe bëni pagesat përkatëse dhe lidhja juaj e ujit legjitimohet.

Konstatimi dhe deklarimi pas këtij afati do t’ju ngarkojë ju me përgjegjësi penale-administrative. Çdo rast do të kallëzohet siç parashikon ligji.

Një falënderim shkon për të gjitha kategoritë e klientëve të rregullt në pagesa ndër vite, të cilët kanë qenë katalizatori i vërtetë, duke e rritur ndërmarrjen dhe duke e çuar përpara këtë sektor. Ju garantojmë gatishmërinë e çdo punonjësi për t’ju shërbyer me korrektësi, mirësjellje në një kohë mjaft të shpejtë.

Uji është jetë

Zbatimi i kësaj platforme, me ndihmesën e të gjithëve, do të thotë:

- Shërbim më i mirë
- Zgjatje e orareve të furnizimit
- Rritje e besimit të donatorët vendas dhe të huaj
- Rritje e cilësisë
- Kursim i shpërdorimit
- Rritje e investimeve dhe mirëmbajtjes.

Shtimi i sipërfaqes së gjelbër, Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit vazhdon mbjelljet e pemëve



Vazhdon zbatimi i projekteve për mbrojtjen e mjedisit dhe rrjedhimisht edhe të përmirësimit të jetës së qytetarëve në gjithë territorin e Bashkisë Kamëz. I tillë është edhe zbatimi i projektit të mbjelljes së pemëve dekorative përgjatë rrugës “Liria”. Financimi i mbjelljes së këtyre pemëve është i tëri nga buxheti i Bashkisë. Zbatimi i një buxheti të mirëkombinuar, të shtrirë në investime dhe shërbime flet qartë për politikë lokale në funksion të qytetarëve. Mbjellja e pemëve dekorative përgjatë rrugës “Liria” është fillimi i programit të sezonit të mbjelljeve në të gjitha segmentet ku janë kryer investimet për dy vitet në vazhdim. Në këtë mënyrë, përveç ndërtimit të infrastrukturës rrugore dhe të kanalizimeve, edhe gjelbërimi i qytetit është në vëmendjen e Bashkisë Kamëz. Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka kërkuar në vazhdimësi zbatimin me korrektësi të të gjitha investimeve dhe shërbimeve me një partneritet në vazhdimësi me grupet e interesit.



Bashkia Kamëz vlerësohet me rezultate maksimale për luftën ndaj korrupsionit

Nentor 2017
GAZETA KAMZA



3

Institucioni i Bashkisë Kamëz vlerësohet me rezultate maksimale për luftën ndaj korrupsionit. Përgjatë vitit 2016 qeveria shqiptare në partneritet me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, filloi zbatimin e projektit "Konsolidimi i reformës administrative dhe territoriale - STAR 2", i cili kishte për qëllim përmirësimin e kapaciteteve institucionale të administratave vendore, ofrimit të shërbimeve dhe angazhimit qytetar, që së bashku synojnë të nxisin një qeverisje më të mirë vendore.



shërbim transparent pa kërkuar ryshfet. Pra, ky institucion është për t'u marrë shembull për sa i përket modelit se si mund të marrësh shërbim pa u kërkuar ryshfet.

Vlerësimi i aktorëve të projektit "STAR 2" bën që institucioni Bashkia Kamëz krahas rezultateve të arritura në investime dhe shërbime, ka dhe një vlerësim maksimal në luftën ndaj korrupsionit.

Projekti "STAR 2" zbatohet në të gjithë vendin dhe prej tij përfitojnë 61 njësitë e qeverisjes vendore, ndërkohë që asistencë është konceptuar në mënyrë të tillë që të mbulojë tre komponentë kryesorë:

- (1) Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të NJQV-ve;
- (2) Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve në nivelin e NJQV-së; dhe
- (3) Përmirësimi i qeverisjes së mirë përmes një procesi vendimmarrjeje, i cili përqendrohet tek qytetari dhe tek pjesëmarrja

domethënëse e tyre në këtë proces.

"STAR 2" bazohet tek angazhimi mbarëkombëtar për reformimin dhe forcimin e qeverisjes vendore dhe të administratës publike në përgjithësi, për rritjen e efikasitetit dhe transparencës së institucioneve publike për t'iu përgjigjur me efektivitet pritshmërive të publikut dhe luftës kundër korrupsionit, për t'i vënë qytetarët në qendër të transformimit dhe modernizimit të ofrimit të shërbimeve dhe për të krijuar një frymë besimi, bashkëpunimi dhe vendimmarrjeje demokratike për zhvillim të shëndetshëm e të qëndrueshëm.

"STAR 2" planifikon të ndjekë të njëjtat masa zbatimi me paraardhësin e tij, "STAR 1". Prandaj, fondi i mbledhur me kontributet e një grupi donatorësh do të menaxhohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e PNUD-it për menaxhimin e projekteve, ku PNUD ka përgjegjësinë, në mirëbesim, për të vepruar në përputhje me rregullat e zbatueshme të menaxhimit dhe raportimit financiar.

Shtrirja gjeografike e projektit do të mbulojë të 61 njësitë e qeverisjes vendore, duke synuar të ofrojë ose garantojë që të gjitha bashkitë të marrin mbështetje koherente për sa i përket fushave që kanë të bëjnë me objektivat e projektit.

Projekti gjithashtu do të përpiqet të

/// Nga kampioni i të anketuarve, është vlerësuar se 95% e tyre kanë deklaruar se në administratën e Bashkisë Kamëz ka një shërbim transparent pa kërkuar ryshfet. Pra, ky institucion është për t'u marrë shembull për sa i përket modelit se si mund të marrësh shërbim pa u kërkuar ryshfet.

plotësojë iniciativat e ndryshme të partnerëve vendas ose të huaj duke punuar mbi çështje që duhen trajtuar për të mundësuar forcimin e të gjitha njësive të qeverisjes vendore. Projekti ndihmon në forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale të NJQV-ve, duke organizuar trajnime të kryetarëve të bashkive, zyrtarëve vendorë dhe lidhshpinit në qeverisjen vendore. "STAR 2" do të mbështetë procesin e përmirësimit të ofrimit të shërbimeve dhe i menaxhimit të tyre (përfshirë kompetencat e reja).

Qendra për Çështje të Informimit Publik INFOÇIP vlerëson transparencën në Bashkinë Kamëz



Është publikuar materiali i prodhuar nga Qendra për Çështje të Informimit Publik INFOÇIP lidhur me transparencën e informimit publik të veprimtarisë së Bashkisë Kamëz, mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Tiranë dhe "Lëviz Albania".

Bashkia Kamëz, e përzgjedhur në sistemin pilot ku kanë qenë të përfshirë në këtë projekt edhe bashkitë Tiranë dhe Vorë, ka realizuar me një përgjegjësi transparencën e përshkruar nga vlerësimi tematik i ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Procesi i vlerësimit të transparencës ka pasur një monitorim pilot edhe të veprimtarisë dhe vendimeve të marra nga ana e Këshillit Bashkiak Kamëz, që rezultojnë një funksionim normal ligjor me marrje vendimesh korrekte në përputhje me ligjshmërinë e funksionimit të Këshillit Bashkiak. Informimi i publikut është bërë në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë Këshilli përkatës për këtë qëllim.

Bashkia Kamëz, nga monitorimi i Qendrës për Çështje të Informimit Publik, rezultojnë se ka të njëjtën performancë si dhe Bashkia Tiranë për sa i përket respektimit të neneve 15, 16, 17, 18, 19 dhe krijon një diferencë në masën 35% për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 20, i cili ka të bëjë me respektimin e iniciativave të vendimmarrjes nga ana e 1% të kërkesës së qytetarëve të çështjeve që përcakton ligji "Për vetëqeverisjen vendore".

Kjo e bën realisht më të besueshëm vlerësimin e performancës mjaft të kënaqshme që ka Bashkia Kamëz në vlerësimin e politikave zhvilluese të qytetit, ku një rol jo pak të rëndësishëm paraqet dhe sa transparent për publikun ka veprimtaria e Bashkisë. Gjithashtu, Bashkia Kamëz ka faqen e saj zyrtare ku mund të ndiqen të gjitha çështjet që informojnë gjerësisht publikun, e cila është www.kamza.gov.al, si dhe bërja transparente e vendimeve të Këshillit Bashkiak Kamëz, të cilat janë të ndërvepruara me platformën kombëtare VENDIME.AL. Në faqen zyrtare ka një rubrikë të dedikuar ku janë publikuar me rregullsi të plotë të gjitha buxhetet dhe paketat fiskale të miratuara që nga viti 2009. Kjo e bën dhe më shumë fleksibël funksionimin e institucionit Bashkia Kamëz.

Bashkia Kamëz, pjesëmarrëse në projektin e BE-së "Bashkitë për në Evropë"



Projekti i financuar nga BE-ja "Bashkitë për në Evropë" zhvilloi në Qendrën e Informimit të BE-së në Tiranë një ditë pune për rrjetëzimin me 61 koordinatorët vendorë të BE-së që janë vendosur në secilën bashki të vendit kandidat. Roli që koordinatorët vendorë kanë në komunikimin e Evropës në nivel vendor, duke sjellë informacion të vlefshëm direkt tek qytetarët e bashkisë së tyre dhe funksionimi i zyrave lokale të BE-së, ishin ndër temat e diskutuara gjatë një dite të gjatë trajnime. Këtë seminar e përshëndeti ambasadorja e Delegacionit të BE, Romana Vlahutin, e cila kujtoi se asgjë nuk do të ndryshojë për Shqipërinë ditën kur vendi do të bashkohet me BE-në, pasi gjithçka do të ketë ndryshuar tashmë më parë. "Unë besoj se qeverisja vendore, duke qenë më afër nevojave dhe dëshirave reale të qytetarëve, është vendi ku ndodhin ndryshimet e vërteta. Dhe me këtë projekt ne do t'ju ndihmojmë të jeni pjesë e këtij ndryshimi", - iu drejtua ambasadorja e BE-së pjesëmarrësve nga e gjithë Shqipëria.

Synimi i takimit kishte të bënte me informimin lidhur me:

1. Rolin e EU Desks brenda bashkive.
2. Rolin (detyrat, përgjegjësitë) në menaxhimin e proceseve në kuadër të funksionimit të EU Desk.
3. Me fillimin e procesit të grumbullimit të të dhënave për realizimin e fazës së parë të matjes së performancës së bashkive (mapping process).
4. Aktivitetet e projektit deri në përfundimin e tij.

Në këtë projekt të financuar nga BE-ja, Bashkia Kamëz u përfaqësua nga koordinatorja për institucionin Bashkia Kamëz, e cila ka rolin e koordinimit të zbatimit të këtij projekti, i cili ka një rol mjaft të rëndësishëm për ecurinë e këtij projekti. Tashmë do të jetë çdo gjë gati për Bashkinë Kamëz për të zbatuar të gjitha hallkat që përmban në kërkesë ky projekt si dhe për ngritjen e këndit të BE-së në ambientet e One Stop Shop-it në Bashki.

Mbledhja e Këshillit Bashkiak, miratohen mes të tjerash projektvendimet me karakter social

Është zhvilluar mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Kamëz. Mes projektvendimeve të miratuara nga këshilltarët, spikatnin ato me karakter social, për mbështetjen e familjeve në nevojë, personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve me nevoja të veçanta. Ndërkaq, u miratuan edhe projektvendimet "Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz për vitin 2018"; projektvendimi "Për miratimin në parim të procedurave të dhënies me qira në favor të të tretëve të pasurive të paluajtshme dhe të ndërtesave në pronësi të Bashkisë Kamëz"; projektvendimi "Për miratimin e skemës për pagesën me këste të detyrimit të abonentëve të ujësjellësit"; lënia në fuqi e VKB-së nr. 110 "Për një ndryshim në VKB nr. 150 datë 15.12.2016 "Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitin 2017".

Duhet theksuar që edhe pse nuk është në kompetencat e Bashkisë (por të qeverisë) për të bërë përzgjedhjen e familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike, kjo Bashki, me mundësitë e veta, është përpjekur që të jetë pranë qytetarëve të saj, veçanërisht pranë shtresave më në nevojë. Ky është edhe synimi i kryebashkiakut Xhelal Mziu, ndihmesa për qytetarët e Kamzës dhe Paskuqanit, si me përkrahje sociale, me investime dhe shërbime të ndryshme.



Përkujtimi i të rënëve për Atdhe, kryebashkiaku Xhelal Mziu, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit

Kryebashkiaku dhe kryetari i PD Kamëz, Xhelal Mziu, zhvilloi homazhe në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, me rastin e Ditës së Çlirimit të vendit. Në këto homazhe merrte pjesë edhe kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, deputetë të grupit parlamentar dhe përfaqësues të tjerë të selisë blu, qindra qytetarë etj. Ata zhvilluan homazhe tek Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, ndërsa nderuan të rënë të luftës. Kryedemokrati Basha, pasi u përku me nderim dhe

vendosi kurora me lule përpara memorialit madhështor, uroi qytetarët, ndërsa në fjalën e tij theksoi: "Flamuri na kujton për çmimin e lartë që ka pasur në shekuj shpallja e Pavarësisë. Na kujton peshën dhe përgjegjësinë për brezat e rinj. Na kujton betejën për Shqipërinë evropiane dhe demokratike si thirrjen më të lartë dhe nderimin më të madh ndaj heronjve tanë", - u shpreh Basha.



Në 28 nëntor 1944, Shqipëria, nga një pushtim i vjetër në një pushtim të ri!

Nga Nga Sali BERISHA

Data 28 nëntor 1944 mbahet si dita e çlirimit të Shqipërisë dhe, siç dihet, edhe sot vazhdon debati mbi saktësinë e datës së çlirimit, nëse kjo ka ndodhur me datë 28, për çka ekzistojnë të gjitha provat se kjo ishte data e pranuar fillimisht. Personalisht jam dakord me historianët se dita e çlirimit, e tërheqjes së ushtrisë gjermane nga Shqipëria mund të ishte secila nga ditët, nga data 17 nëntor e tutje. Madje, me logjikën qesharake të largimit të gjermanit të fundit nga Shqipëria, kjo datë mund të ishte 2 apo 4 e më shumë dhjetor.

Por data 29 nëntor, siç pretendon e majta shqiptare, ka simbolikë antishqiptare, pasi përfaqëson datën e falsifikuar nga Enver Hoxha, ndonëse ai vet, jo vetëm që u instalua në krye të qeverisë së tij më datën 28 nëntor 1944, por edhe një vit më vonë ai festoi çlirimin po me datën 28 nëntor. Pra rëndësia e këtij debati qëndron në faktin se, Enver Hoxha falsifikoi edhe këtë datë, për ta njehësuar këtë festë jo me ditën e çlirimit por me festën kombëtare të Federatës së Jugosllavisë, pra me ditën e shpalljes së saj nga J. Broz Tito në Jajcë, më 29 nëntor të vitit 1943. Diktatori Hoxha falsifikoi datën e çlirimit në mënyrë që, pas bashkimit si Republikë e 7-të me Federatën Jugosllave, Shqipëria do të festonte edhe ajo më 29 nëntor, së bashku me republikat e tjera, jo Jajcën, por Çlirimin e saj.

Por në rast se për datën e çlirimit debati përsëritet çdo nëntor mjerisht, ende sot e kësaj dite jo pak shqiptarë dhe në tërësi e majta shqiptare, nuk janë ndalur dhe nuk ndalen dot në një aspekt tjetër themelor të kësaj date. Ata nuk janë ndalur në të vërtetën më të pamohueshme historike, se 28 nëntori i vitit 1944 shënoi jo vetëm çlirimin nga një pushtim i huaj, me saktë largimin e një pushtuesi të huaj nga Shqipëria por dhe zëvendësimin e atij pushtimi me një pushtim tjetër të huaj dhe me një pushtim të brendshëm pasi, në fronin e pushtetit në Tiranë, u ul një klikë terroriste shqiptaro-serbe me projekt kryesor zhdukjen e shtetit të pavarur të shqiptarëve.

Sot historianë dhe studiues, vendas dhe të huaj, me botimet e tyre serioze dhe të shumta, të bazuara në mijëra dokumente të arkivave të vendit, të aleatëve dhe vendeve të tjera, kanë rishkruar historinë në dritën e të vërtetave të pamohueshme historike. Ata, me veprat e tyre tejet të rëndësishme, kanë shkruar si rrezet e diellit brymën, malin e lartë të falsifikimeve të historiografisë hoxhiste. Prandaj sot, bazuar në të vërtetat historike shkencore është koha për reflektim të thellë nga çdo shqiptar kudo që jeton, për historinë tonë në tërësi, si dhe në rastin konkret, edhe rreth kësaj date.

Studimet, botimet të historianëve shqiptar, seriozë e të lirë të këtij çerek shekulli, të bazuara në dokumente dhe raporte të kohës, kanë provuar në mënyrë shteruese se J. B. Tito dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë, themeluan me dy qëllime kryesore me të dërguarit e tyre në nëntor të vitit 1941 në Tiranë, për interesa të serbomadhisë, Partinë Komuniste të Shqipërisë. Qëllimi i parë dhe më kryesor ishte krijimi i kalit të Trojës, pra i një partie dhe lëvizje jugosllave në Tiranë, të drejtuar dhe urdhëruar dhe përdorur prej tyre kundër çështjes shqiptare. Qëllimi i dytë ishte që, në zbatim të porosive të Kominternit pas sulmit nazist ndaj Bashkimit Sovjetik, kjo forcë dhe kjo lëvizje shqiptaro-serbe të mobilizonte shqiptarët në luftë kundër pushtuesve. Në këtë kontekst, është provuar se të deleguarit, komunistë serbo-malazez, shkruan programin e PKSHE, pa iu referuar as dhe një herë Kosovës dhe çështjes shqiptare. Ata de facto vunë në krye të PKSHE Miladin Popoviçin dhe emëruan rreth tij Enver Hoxhën dhe vasalët e tjerë. Ata, siç pohon dhe

vet Tito, themeluan, udhëhoqën dhe urdhëruan këtë parti dhe njësitë e saj partizane, si parti dhe lëvizje jugosllave, gjatë gjithë luftës. Tito dhe PKJ, me kalin e saj të Trojës PKSHE në Tiranë, arriti me sukses të bllokojë bashkimin e shqiptarëve në Shqipëri dhe bashkimin e kombit shqiptar në tërësi, në luftën kundër pushtuesve. Ata, me ndihmën direkte të PKSHE dhe Enver Hoxhës dhe shqiptarëve me origjinë nga Kosova, që u dërguan aty me mision si Fadil Hoxha etj, arritën të vendosin Kosovën nën vartësinë e PKJ, pavarësisht se Federata Jugosllave nuk ekzistonte. Tito dhe PKJ, nëpërmjet lëvizjes së tyre jugosllave që themeluan në Tiranë, realizuan sa më sipër jo vetëm duke përjashtuar tërësisht çështjen kombëtare nga programi i PKSHE, por dhe duke imponuar anulimin e menjëhershëm të Marrëveshjes së Mukjes, injorimin dhe asgjësimin e Marrëveshjes së Bujanit, dërgimin e brigadave dhe divizioneve partizane të Shqipërisë në Kosovë me pretekstin e çlirimit të saj nga gjermanët. Por në të vërtetë ato hynë si pararojë e pushtimit të Kosovës nga divizionet serbo-malazeze dhe bashkautorë në vendosjen e saj në administrim ushtarak nga Tito dhe masakrat e mëdha ndaj shqiptarëve, si masakra e Tivarit etj.

Krahas këtyre, historianët dhe studiuesit kanë faktuar me dokumente se: udhëheqësit jugosllavë dhe vegla e tyre Enver Hoxha, pas shtatorit 1943 degraduan me qellim luftën e shqiptarëve kundër pushtuesve në një luftë kryesisht vëllavrasëse civile dhe se PKSHE, siç pranojnë unanimisht vet Enver Hoxha dhe udhëheqja e tjetër e kësaj partie në Plenumin e Dytë të Beratit, zbatoi gjatë luftës një vijë politike terroriste, pra veprimi si një organizatë e tillë dhe se udhëheqja e saja kishte kryer, urdhëruar në dhjetëra e qindra raste akte të mirëfillta terroriste. Këto studime, të bazuara në dokumente të panumërta, kanë provuar se serbët, Enver Hoxha dhe vasalët e tyre të tjerë shqiptarë në krye të ushtrisë partizane të Shqipërisë dhe Kosovës kryen gjatë luftës kundër pushtuesve, gjenocid dhe krime të rënda kundër njerëzimit ndaj shqiptarëve. Përveç këtyre, klika terroriste serbo shqiptare në krye të ushtrisë partizane dhunoi në Shqipëri në qindra e qindra raste konventat ndërkombëtare të Gjenevës, Hagës, për mbrojtjen e popullatës civile, robërve të luftës, të sëmurëve dhe të plagosurve të luftës, etj., etj. E vërteta të detyron, thotë një fjalë latine, prandaj sot është në interes të çdo shqiptari, të raportit të tij me të vërtetën historike të kombit të vet të shtrojë pyetjen: A u çliruam vërtet në shqiptarët, me datë 28 nëntor 1944? Në përpjekjen për një përgjigje objektive të kësaj pyetje do të gjejmë? se e vërteta e çlirimit tonë, është një? medalje me dy faqe. Në njërin anë, është e vërtetë se, në raport me pushtimin gjerman, ne u çliruam pasi gjermanët, në humbje e sipër të luftës, u tërhoqën nga Shqipëria në nëntor të vitit 1944 dhe ne shqiptarët dolëm nga Lufta e Dytë Botërore të renditur në anën e aleatëve.

Po me 28 nëntor të vitit 1944, Enver Hoxha u instalua në Tiranë me qeverinë? e tij dhe mbajti fjalimin e gjatë të fitores. Gjatë kësaj lufte, flijuan jetën dhe rininë e tyre, mijëra djem dhe vajza, burra e gra të kombit tonë dhe, dhjetëra mijëra të tjerë luftuan me guxim, vendosmëri pushtuesit nazifashistë dhe renditën kështu Shqipërinë, në anën e drejtë të historisë. Nderimi për ata që flijuan jetën për idealet e lirisë do mbetet i përjetshëm. Gjaku dhe sakrificat e tyre qëndron në themele të lirisë tonë kombëtare. Sikundër i tillë do mbetet nderimi edhe për të gjithë ata që luftuan kundër pushtuesve për lirinë kombëtare dhe nuk u sollën gjatë luftës si kainë ndaj vëllezërve të tyre, nuk kryen akte terroriste, gjenocide dhe krime kundër njerëzimit. Ndërsa të gjithë autorët e akteve të tilla, për krimet e tyre monstruoze, kanë përfunduar dhe do të përfundojnë

aty ku dhe e kanë vendin, në koshin e plehrave të historisë. Me këtë rast dua të shtojë këtu se, këto të vërteta historike nuk mund të mohohen, pavarësisht nga manipulimet dhe falsifikimet monstruoze të luftës nga historianët hoxhistë, si rritja me disa herë i numrit të të rënëve, shpikja e betejave edhe të paqena, stërfryrja e humbjeve të shkaktuara armikut etj etj. Këto të vërteta për luftën partizane, nuk mund të mohohen as nga gjenocidi dhe krimet kundër njerëzimit që udhëheqja komuniste shqiptaro-sllave kreu gjatë luftës, madje nuk mund të mohohen as dhe nga karakteri vëllavrasës dhe civil që dominoi këtë luftë, pasi Enver Hoxha dhe klika e tij, për qëllime të pushtetit personal dhe i urdhëruar nga padronët e tij serb, i dhanë me qellim asaj pas shkelmimit nga ai të Marrëveshjes historike të Mukjes, në shtator të vitit 1943. Këto të vërteta nuk mund të mohohen as dhe nga disa veçori të pamohueshme të pushtimit gjerman në Shqipëri apo mungesa e betejave frontale kundër tyre. Ato nuk mund të mohohen as dhe nga fakti se ushtritë gjermane u tërhoqën vetë për qëllimet e tyre gjeostrategjike, jo vetëm nga Shqipëria por edhe zona të tjera të rajonit.

Në idenë e saj, lufta kundër pushtuesve, ishte një luftë e drejtë.

Aleatët anglo-amerikanë kishin njohur, vlerësuar, mbështetur, financuar dhe furnizuar me armë, uniforma, ushqime, para, specialistë, ushtrinë partizane. Qeveritë e vendeve aleate kishin mirëpritur dhe përhëndetur që në fillim luftën e shqiptarëve kundër pushtuesve. Në mënyrë të pamohueshme forcat partizane komuniste ishin dhe njësitë më të organizuara dhe më numerike në teatrin e luftës në Shqipëri. Por duhet thënë se kjo jo për shkak të mbështetjes së tyre të gjerë në popull, por para së gjithash për shkak të dobësive të pamohueshme dhe qëndrimeve kaotike të nacionalistëve shqiptarë. Është i drejtë dhe plotësisht i justifikuar, dhe mendoj unë i detyrueshëm, dënimi me ashpërsi i të gjitha qëndrimeve çnjerëzore antikombëtare të klikës serbo-shqiptare që udhëhoqi luftën. Por, është tejet i gabuar mohimi i luftës, i gjakut të derdhur dhe sakrificave të mëdha që partizanët pavarësisht nga orientimi i tyre politik bënë për liri. Nuk duhet të harrojmë asnjëherë se renditja në anën e drejtë të luftës së Dytë Botërore pati një rëndësi të veçantë për Shqipërinë. Kjo, jo vetëm për dinjitetin kombëtar të shqiptarëve por edhe për faktin se, me gjithë mbështetjen që aleatët i kishin dhënë luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesve, ata, që në krye të herës kishin lënë të hapur, dhe këtu me sa duket nën ndikimin e Greqisë, çështjen e përcaktimit të kufijve të Shqipërisë. Sipas tyre, kufijtë e Shqipërisë do të caktoheshin pas luftës, në konferencën e Paqes. Këtu qëndron më shumë se në çdo drejtim tjetër dhe rëndësia e pamohueshme e renditjes së Shqipërisë në anën e aleatëve, pasi renditja në anën e kundërt, gjë për të cilën kishte edhe shqiptar që punonin, mund të shoqërohej me ndëshkime të rënda, si palë e humbur.

Por ana tjetër, ana e zezë e medaljes së datës së 28 nëntorit 1944, pra datës së Çlirimit, është se kjo datë, jo që nuk do të shënonte çlirimin e vërtetë të shqiptarëve dhe Shqipërisë, por vetëm do të sillte zëvendësimin e pushtimit gjerman me specifikat e tij me pushtimin serb, jugosllav shumë herë më të rrezikshëm për vet ekzistencën e kombit shqiptar, si dhe vendosjen e diktaturës 46 vjeçare më të egër, më moniste, si pushtimi i brendshëm më barbar, që shqiptarët kishin njohur në tërë historinë? e tyre. Kështu që, kjo ditë e nëntorit të vitit 1944, është edhe dita e vendosjes së një pushtimi më të zi për shqiptarët. Këtu më poshtë do të ndalem shkurtimisht në



vendosjen e pushtimit serb, jugosllav, pas 28 nëntorit të vitit 1944, në Shqipëri. Ky zëvendësim i pushtimeve ndodhi sepse, në Tiranë, në pushtet do të vinte partia dhe ushtria e themeluar, e drejtuar dhe e udhëhequr nga serbët e PKJ dhe Tito, dhe vegla e tyre Enver Hoxha, të cilët pasi shitën Kosovën, kishin vendosur dhe punonin së bashku me Beogradin për projektin ogurzi e antikombëtar, aneksimin e Shqipërisë si Republikë e 7-të e Jugosllavisë. At Zef Pllumi, dëshmitar i çlirimit të Shkodrës, shkruan në kryeveprën e tij "Rr'no vetëm me tregue" se: me datën 29 nëntor Shkodra u gdhi e mbushur me flamuj jugosllavë dhe se në këmbanoren e Katedrales së qytetit, flamuri shqiptar pa yll u zëvendësua nga një partizan me flamurin jugosllav. Pra, në qytetin e përjetshëm të shqiptarëve, si dëshmi tragjike e zëvendësimit të pushtimeve, flamuri i pushtuesit që iku u zëvendësua jo me flamurin kombëtar, por me flamurin e pushtuesit të ri. Kështu mjerisht, më 28 nëntor të vitit 1994, shqiptarët festuan çlirimin, lirinë, të mashtruar si kurrë më parë në historinë e tyre dhe, duke mos e kuptuar shumë prej tyre se, pikërisht këtë datë, ata hynë në një pushtim të ri. Më saktë ata brohoritën atë ditë një klikë shqiptaro-jugosllave me në krye Enver Hoxhën, që u instalua në pushtet me projektin makabër të asgjësimit të lirisë së tyre kombëtare, pavarësisë së Shqipërisë dhe aneksimin e saj si Republikë e 7-të në Federatën e Sllavëve të Jugut, armiqve shekullorë të kombit shqiptar.

Pas kësaj dite pra, 28 nëntorit 1944, instalimit në Tiranë të klikës shqiptaro-serbe të Enver Hoxhës, vendosjes nga ky i fundit i veriut të Shqipërisë dhe më pas edhe Kosovës nga Tito në pushtim dhe administrim ushtarak, gjenocidi dhe krimet kundër njerëzimit në Shqipëri dhe në Kosovë, do të merrnin dhjetëra mijëra jetë të pafajshme, ose do të largonin nga vendi mbi qindra, mijëra shqiptarë. Me këtë dhunë dhe terror të egër ndaj shqiptarëve, Tito me vasalin e tij Enver Hoxha, me ushtritë e tyre partizane do të vazhdonin të ecnin me vendosmëri në zbatimin e doktrinës së Çubrilloviçit në Kosovë, por në një farë varanti të saj edhe në veriun e Shqipërisë. Ata manu militari do të zhduknin çdo pengesë në rrugën e aneksimin të plotë të Kosovës si krahinë e Republikës së Serbisë, si dhe për asgjësimin e pavarësisë dhe bashkimin e Shqipërisë me Federatën e Sllavëve të Jugut, si Republikë e shtatë e saj. Aneksimi i Shqipërisë nga Federata Jugosllave, ishte akti i fundit i tragjedisë së madhe që Josif Broz Tito, PKSH dhe Enver Hoxha, po realizonte ndaj shqiptarëve. Ky akt, vinte si kurorëzim i instalimit të kalit të Trojës në Tiranë, injorimit total gjatë luftës nga Enver Hoxha, të çështjes së Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, vendosjes së tyre në vartësi të PKJ dhe mbështetjes së plotë të pushtimit serb të tyre. Aneksimi i Shqipërisë si Republikë e 7-të e ish- Jugosllavisë, ishte një projekt i Titos dhe udhëheqjes jugosllave, që në vitet e luftës. Me përfshirjen e Shqipërisë si Republikë e 7-të e Federatës Jugosllave, përveç ëndrrës së vjetër të Serbisë, daljes së saj në Durrës, sipas tyre do të merrte një zgjidhje përfundimtare edhe problemi i shqiptarëve të Kosovës në kuadrin Federatës së Jugosllavisë. Madje, duket se për këtë projekt, ata kishin bindur edhe vetë Stalinin, i cili në takimin me Titon dhe delegacionin e tij në Moskë, i kishte porositur që të "gllabëronin Shqipërinë". Në të vërtetë, në dokumentin e AVNOJ-it, në nëntor 1943, udhëheqja komuniste jugosllave, nuk ftoi fare përfaqësuesit e Kosovës dhe në kundërshtim me atë çka kishte premtuar, Kosovën e la si krahinë të Serbisë. Në këtë konferencë, Tito shpalli në letër Republikën Federative të Jugosllavisë dhe njësitë apo Republikat e saj. Ai, në këtë dokument, kishte lenë të hapur mundësinë e pranimit në federatë të republikave të tjera, natyrisht pa cituar nominalisht Shqipërinë por duke vetëkuptuar, para së gjithash, atë.

Kështu që, pas datës 28 nëntor 1944, jo rastësisht por në funksion të zbatimit të projektit të aneksimin të Shqipërisë nga federata e Titos, në zyrat e pushtetit të ri në Tiranë, në të gjitha nivelet e tij në parti, qeveri, ushtri, polici, sigurim, arsim, tregti, ndërtim, miniera, etj., etj., do të vërshonin këshilltarët jugosllavë, vendim-marrësit e vërtetë të vendit. Jugosllavizimi me shpejtësi dhe në çdo qelizë i shtetit dhe shoqërisë shqiptare, ishte misioni i tyre më kryesor. Madje, autoritetet jugosllave me lejen e Hoxhës, do të instalonin në Shkodër, legalisht një seksion të shërbimit OZNA (shërbimit të fshehtë jugosllav, para ardhjes se UDB) që vepronte e ushtronte terror njëlloj si në Kosovë, i pavarur dhe me autoritet të plotë kundër qytetarëve shqiptarë në mbarë veriun e vendit. Ky seksion i OZNA-s, në mënyrë të pavarur nga autoritetet shqiptare, ndalonte, arrestonte, rrëmbente për në ish- Jugosllavi, madje edhe pushkatonte brenda territorit të Shqipërisë, qindra dhe qindra shqiptarë, të cilët i konsideronin anti-jugosllavë. Në bashkëpunim të ngushtë me këshilltarët e Titos dhe me zell dhe entuziazëm të veçantë, udhëheqja komuniste e Shqipërisë, do të përfundonte dhe do të firmoste me shpejtësi të rrufeshme, që në muajin dhjetor të vitit 1944, Traktatin e Bashkëpunimit dhe Ndihmës së dyanshme midis Tiranës dhe Beogradit, si kuadër

ligjore i paradhomë se bashkimit midis dy vendeve. Traktatin e firmosi vetë Marshalli Tito.

Të dy qeveritë, po në procesin e bashkimit të plotë të të dy vendeve, firmosën një seri marrëveshjesh të tjera për bashkimin ekonomik, doganor, monetar. Krejt ndryshe nga sa paraqitej më vonë nga historianët hoxhistë, Enver Hoxha, firmosi dhe pranoi që të dislokohehin në Shqipëri divizione të ushtrisë Jugosllave. Ai pas kësaj, i propozon Titos, bashkimin e ushtrive me një Komandë dhe Shtatmadhëri të përbashkët, pra unifikimin e komandës ushtarake të të dy ushtrive. Në sistemin arsimor të vendit, në të gjitha nivelet, serbishtja do të bëhej gjuha e detyruar. Të gjitha shkollat, klasat, sallat dhe oborret e tyre, buçisnin nga këngët dhe brohoritjet për Marshallin Tito, për bashkim vëllazërimin me popujt e Jugosllavisë. Letrat, artet, muzika, folklori, prodhimet e tjera artistike jugosllave, do të mbushnin boshllëkun e krijuar me ndalimin e veprave letrare artistike të shkrimtarëve dhe artistëve shqiptarë, që nuk kishin mbështetur apo kishin kundërshtuar vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri. Enver Hoxha do të mbante fjalime në Kuç e gjetiu kundër Fishtës. Ai, në këto fjalime do të krahasonte gjeniumin e epikës së letrave tona me Vladan Gjeorgjeviçin, ish-kryeministrin serb në vitin 1913, që kishte kryer masakrat më të mëdha ndaj shqiptarëve dhe ishte shprehur se "shqiptarët, janë njerëz primitivë". Independentistët, ata që shpreheshin për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë shpallëshin si revanshistë.

Për klikën e Tiranës dielli tashmë lindte nga Beogradi!

Ekonomia shqiptare u vendos e tëra në duart dhe kontrollin e dhjetëra e dhjetëra ndërmarrjeve jugosllave, që u krijuan me shpejtësi në Shqipëri. Të gjitha shkëmbimet tregtare bëheshin pothuaj ekskluzivisht me Beogradin. Vetëm në këto shkëmbime, midis të tjerash, Beogradi grabiste nga Shqipëria sasinë kolosale dhjetëra e dhjetëra tonelata flori, dhe mallra të tjera të cilat pushtetarët komunistë ua konfiskuan, me gjak e hekur, tregtarëve, sipërmarrësve, qytetarëve shqiptarë dhe morën si kundër vlerë punishte, vagonë, hekurishte të pa vlerë. Për Enver Hoxhën dhe suitën e tij kriminale antishqiptare, zhdukja nga harta e Shqipërisë së pavarur, bashkimi i saj me Federatën e Jugosllavisë si Republikë e 7-të e kësaj federate, ishte e ardhmja më e mirë, më e sigurt e kombit shqiptar. Në kontekstin e aneksimin të Shqipërisë, asgjësimit të pavarësisë së saj, në mbledhjen e Byrosë Politike, të dt. 8 Janar 1945, Enver Hoxha si promotor kryesor i bashkimit të Shqipërisë me



Jugosllavinë, propozon "bashkimin e PKSH me PKJ, mbi baza federative, me Sekretar të Përgjithshëm për PKSH Marshallin Titon, si kusht i domosdoshëm i bashkimit të Shqipërisë me Federatën Jugosllave. Vendosmërinë e tij për zhdukjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe bashkimin e saj si Republikë e 7-të me Federatën Jugosllave, Enver Hoxha, do ta dëshmonte edhe nëpërmjet një letre te drejtuar Josif Broz Titos, lidhur me bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Në këtë letër, ndër të tjera, Enver Hoxha shkruan: "nga shoku Savo, na është sugjeruar... një hap tjetër përpara në lidhje me formimin e shteteve tona, d.m.th., në rast se shkohet sa më shpejt në bashkimin e dy popujve tanë", dhe se vazhdon ai: "ky bashkim, s'ka asgjë formale, por ndihet thellë në zemrat e popullit tonë. Ne, duhet të punojmë konkretisht për Federatën dhe për këtë gjë, në vendin tonë punohet me të gjitha format".

Më poshtë, Hoxha vazhdon: "ne kemi nevojë të na thuhet nga ju, nëse ka ardhur momenti kur neve duhet të marrim në shqyrtim çështjen e bashkimit dhe të mbërrimë në konkluzione", dhe së fundi "ne kemi bindjen se, sikundër Komiteti Central i Jugosllavisë do të na sqarojë dhe do të na këshillojë hapat dhe shoqërisht mbi këtë çështje të rëndësishme për të dy vendet tona". Po në këtë linjë është edhe deklarata e Titos dhënë agjencisë AP, në vitin 1946, se, "Kosova dhe territoret e tjera shqiptare do t'i aneksohen Shqipërisë". Kjo deklarata, është bërë vetëm e vetëm me projektin e "gllabërimit të Shqipërisë etnike" pra, Shqipërisë, Kosovës dhe territoreve të tjera shqiptare, si dhe shndërrimin e tyre në Republikën e 7-të të Jugosllavisë.



Ky projekt ogurzi, në të cilin ora e kombit shqiptar kishte ndaluar edhe ecte me orën e Beogradit, po shkonte i sigurt dhe pandalshëm drejt realizimit të tij. Ai do të dështonte vetëm për shkak të keqësimit dhe prishjes së shpejtë të marrëdhënieve midis Stalinit dhe Titos, prishje kjo që nuk kishte asnjë lidhje me Shqipërinë apo marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, por që sigurisht, tashti Stalini nuk do të pranonte aneksimin nga armiku i tij Tito, të Shqipërisë. Kështu që Shqipëria, de fakto e pushtuar nga jugosllavët nuk u shndërrua dot sipas projektit Tito -Enver në Republikë të 7-të të Jugosllavisë por kjo nuk ndryshon faktin se 28 nëntori 1944, dita që Enver Hoxha dhe qeveria e tij hyri triumfalisht në Tiranë është gjithashtu edhe dita e triumfit të serbëve, armiqve tanë shekullorë mbi të gjithë shqiptarët. Në shekuj shqiptarët dhe serbët ishin përballur me dhjetëra e dhjetëra herë.

Nga mesi i viteve 1800 e këtej, serbët i kishin fituar në tërësi të gjitha luftërat kundër shqiptarëve, kishin dalë në Durrës dhe pushtuar shumicën e territoreve tona, kishin kryer gjenocide dhe masakrat më të tmerrshme ndaj nesh. Kishin arritur të bindin zotërit e kësaj toke se nuk ekzistonte komb shqiptar. Por, në të gjitha këto luftëra, serbët kishin pasur ndihmën politike, ushtarake, financiare të perandorive më të mëdha të kohës, përveç Austro-Hungarisë.

Kurse fitoren e tyre më të madhe qe nga koha e Car Dushanit ndaj kombit shqiptar, fitoren e 28 nëntorit të vitit 1994, serbët e arritën jo me mbështetjen dhe ndërhyrjen direkte në anën e tyre të fuqive të mëdha, por e realizuan nëpërmjet shqiptarëve, kalit të Trojës, lëvizjes jugosllave që themeluan dhe udhëhoqën në Shqipëri dhe Kosovë, me Enver Hoxhën dhe veglat e tyre në Shqipëri, Fadil Hoxhën dhe vasalët e tjerë shqiptarë në Kosovë. Me gjithë këto, e majta shqiptare e kryesuar nga Edi Rama mban ndaj kësaj dite qëndrim të njëjtë identik me atë të diktatorit stalinist Enver Hoxha.

Edi Rama, pinjoll i bllokmenëve hoxhist, 27 vite me parë thërriste dhe shkruante "Të sulmojmë bllokun", "të nxjerrim jashtë ligjit PPSH". Sipas tij, "lufta lufta kundër okupatorit degjeneroi në një luftë të përgjithshme civile", "shkaktare e të cilës ishte PKSH, e drejtuar nga emisarë jugosllavë" dhe se kjo ndodhi, "për shkak të luftës për pushtet të gjeneral Enver Hoxha" dhe se "Partia Socialiste që ka dalë nga mitra e përgjakur e krimit të PPSH duhet të dalë jashtë ligji ose të rithemelohe". Apo se "Kongresi i Përmetit ishte legjitimimi i diktaturës". Madje dhe se, "Për sa kohë PS nuk ka bërë denoncimin e plotë të origjinës dhe historisë së saj, ajo nuk mund të ketë të drejtën për të qenë një parti e ligjshme". Asokohe Edi Rama nuk kursente as të rënë për liri, ai shkruante se "gjaku i dëshmorëve është gjaku i rremë në themel të kolltukëve..." Në këto konsiderata të Edi Ramës, 26 vite më parë ka të vërteta historike të pamohueshme. Por si për të faktuar hipokrizinë dhe falsitetin, mjerimin e tij sapo do vinte në pushtet në vitin 2013, Edi Rama do festonte më 29 nëntor ditën e çlirimit i rrethuar nga portrete të Enver Hoxhës, dhe do t'i shpërndante ato pamje me rrjetin e tij social FB personal në mbarë botën. Në një akt të vërtet antikombëtar, edhe sot, pas 70 vitesh, megjithëse ish-pushtuesit e para 28 nëntorit të vitit 1944 janë miqtë dhe partnerët tanë strategjikë ndër më kryesoret, Edi Rama mban ende si kryefestë të të majtës shqiptare ditën e largimit të gjermanit të fundit nga Shqipëria dhe ditën parë të pushtimit serb, dhe kjo vetëm e vetëm për të mbrojtur atë si trashëgiminë e etërve të saj barbarë, mizorë e tradhtarë.

Madje Edi Rama, për t'i bërë karshillëk njëlloj si etërit e tij, ditës së pavarësisë dhe mbajtur gjallë si festë, i ka vendosur kësaj date mbrapa si mballomë edhe Natën e Bardhë. Në këtë shkrim u ndala shkurtimisht vetëm në njërin aspekt tragjik që mbarte në vehte ajo që e majta shqiptare e feston si ditë çlirimi dhe që e kremton jo për të nderuar të rënë e luftës as dhe luftëtarët idealistë të saj, por për të mbrojtur terroristët, xhelatët, kliken serbo-shqiptare të Enver Hoxhës që u instalua në Tiranë më datën 28 nëntor të vitit 1944. Sikundër shtoj se nuk u ndala këtu në aspektin më katastrofal të kësaj date, si ditë e parë e vendosjes së diktaturës moniste më mizore të të gjitha kohërave në Shqipëri, diktaturës hoxhiste.

Duke përfunduar ftoj çdo shqiptar, që në dritën e të vërtetave të pakundërshtueshme të historisë dhe për hir të raportit me të vërtetën që duhet të ketë njeriu i qytetëruar të reflektojë rreth saj! Më mirë vonë se kurrë!



22 nëntori 1908 - Kur Kongresi i Manastirit përcaktonte alfabetin e gjuhës shqipe

Kongresi i Manastirit (apo Kongresi i Alfabetit) është tubimi i dijetarëve shqiptarë më 14 nëntor - 22 nëntor 1908 në Manastir, për përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Në të morën pjesë 50 delegatë nga 26 qytete të ndryshme, klube dhe shoqata. Në këtë Kongres u miratua vendimi që të pranohet alfabeti latin me disa ndryshime të shkronjave duke i përshtatur ato për gjuhën shqipe.

Gjatë rrugës së zhvillimit historik të letërsisë shqipe ishin hartuar disa alfabetë të ndryshme. Njëri nga më të fundit ishte ai i krijuar në Stamboll dhe quhej Alfabeti i Stambollit. Mendimi zotëruar ishte se shkronjat jolatine nuk ishin të përshtatshme për mbarësinë e shqipes dhe bashkimit gjuhësor kombëtar. Për këtë arsye, shoqëria më aktive dhe e mirënjohur "Bashkimi" në Manastir, thirri Kongresin e Parë të Përgjithshëm për diskutimin e një alfabeti të njësuar. Një alfabet i njësuar do të ishte fillimi i letërsisë mbarëshqiptare. Prandaj më 14 nëntor 1908 në Manastir u mbledh Kongresi i Manastirit ose Kongresi i Alfabetit. Në Manastir, në atë kohë, kanë marrë pjesë intelektualë shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare, pasi qyteti ka qenë qendër e konsujve dhe ishte më i sigurt për mbarëvajtjen e këtij procesi të rëndësishëm kombëtar.

Kryetar i Kongresit u zgjodh Mit'hat Frashëri, kurse nënkryetarë ishin Luigj Gurakuqi dhe Gjergji Qiriaz, ndërsa motra e tij Parashqevi Qiriaz, ishte gruaja e vetme në këtë Kongres.

Sipas numrit dhe rëndësisë së pjesëmarrësve, Kongresi i Manastirit ka qenë ngjarja më e rëndësishme e popullit shqiptar në fillimet e shekullit XX, ku si rezultat i kësaj pune më 28 Nëntor të vitit 1912 u shpall edhe pavarësia e Shqipërisë. Për shqiptarët e Maqedonisë kjo ditë është ditë feste dhe nuk punohet, ndërsa në Manastir funksionon Muzeu i Alfabetit të Gjuhës Shqipe, në të cilin gjenden rreth 56 fotografi të pjesëmarrësve dhe 230 dokumente në formë digjitale dhe në letër.



Në foto - pjesëmarrësit e Kongresit të Manastirit

Rreshti i parë (nga lart, nga e majta: Sami Pojani (delegat i Korçës), Zenel Gllina (i Leskovikut), Leonidha Naçi (i Vlorës), Simon Shuteriqi (i Elbasanit), Dhimitër Bruda (i Elbasanit), Azis Starova (i Starovës), Adham Shkaba (i Sofjes), Mati Logoreci (i shoqërisë "Agimi").

Rreshti i dytë: Rrok Berisha Gjakova (i Shkupit), Bajo Topulli (i Gjirokastrës), Grigor Gilka (i Korçës), Sotir Peci (i Amerikës dhe i Bukureshtit), Shefqet Frashëri (i Korçës), Luigj Gurakuqi (i Shkodrës), Shahin Kolonja (i Kolonjës), Ahil Eftim Korça (i Konstancës), Hil Mosi (i Shkodrës).

Rreshti i tretë: Nyzhet Vrioni (i Beratit), Dhimitër Mole (i Filibesë - Bullgari), Gjergj Qiriaz (i Manastirit), At Gjergj Fishta (i shoqërisë "Bashkimi"), Mid'hat Frashëri (i Klubit të Selanikut dhe Janinës), Dom Nikollë Kaçori (i Durrësit), Dom Ndre Mjeda (i shoqërisë "Agimi"), Fehim Zavalani (i Manastirit).

Rreshti i katërt: Refik Toptani (i Tiranës), Çerçiz Topulli, Mihal Grameno (i Korçës). Anash janë dy patriotë jo delegatë.

Nga Mihal Gramenoja, në kujtimet e tij, përmenden si pjesëmarrës - por që mungojnë në këtë fotografi: Parashqevi Qiriaz (delegatë e Shkollës së Çupave Korçë), Havez Ibrahim dhe Emin Beu (të Shkupit), Rauf Beu (i Gjirokastrës) dhe Selahedin Beu (i Manastirit).

Historia e Kongresit

Kumtesa e mbajtur nga prifti katolik Gjergj Fishta, nga Shkodra, preku të gjithë pjesëmarrësit, sa një

hoxhë rendi ta përqafonte para të gjithëve. Kërkesa e kombëtaristëve shqiptarë ishte që gjuha shqipe të mos shkruhej as me shkronja arabe, as me shkronja greke, por me alfabetin latin, gjë që do të nënkuptonte mosnënshtrim, qoftë ndaj otomanëve, qoftë ndaj grekëve. Kongresi vendosi me votë unanime të lërë mënjanë alfabetin e Stambollit, dhe ta shkruanin gjuhën shqipe vetëm me alfabetin latin me 36 shkronja i cili përdoret deri më ditët tona. Gjithashtu, u vendos që pas dy vjetësh të mbahej një Kongres i dytë në Janinë për të shqyrtuar problemet drejtshkrimore e letrare, si dhe për të bërë përpjekje për shkrimin e dialekteve gegë dhe toskë në një gjuhë të njësuar shqipe. Duke qenë se para Kongresit të Manastirit, gjuha shqipe ishte shkruar me shkronja arabe, greke, sllave apo përshtatjet e tyre, vendosmëria e delegatëve për t'i kthyer sytë nga perëndimi ishte haptazi një shpallje kulturore e pavarësisë, gjë që nuk kaloi pa u vënë re as nga qeveria turke e as nga kisha ortodokse greke dhe aleatët e tyre sllavë.

Dom Ndre Mjeda, i thuri vargjet, ndoshta më të bukura gjuhës shqipe në atë kohë:

*Përmbi zâ, që lëshon bylbyli,
Gjuha shqipe m'shungullon,
Përmbi erë, qi nep zymbyli,
pa 'da zemrën ma ngushëllon.
Gegë e toskë, malësi, jallia,
jan një komb, m'u 'da s'duron,
fundë e majë një është' Shqipnia,
e një gjuhë t'gjith na bashkon.*

Në Manastir u hap dhe shtypshkronja, e cila financohej nga një grup tregtarësh atdhetarë myslimanë shqiptarë. Shtypshkronja e Manastirit shpejt u bë e njohur në të gjithë Shqipërinë si shpërndarëse e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Në këtë punishte ishin të punësuar 17 vetë, të cilët punonin me një makinë të re elektrike, që vihej në lëvizje me dorë, për të shtypur gazetën e përjavshme "Bashkimi i Kombit" si dhe abetaret shqipe dhe tekstet shkollore.

Ndërkohë çështja e gjuhës shqipe shpesh bëhej shkas shpërthimit dhe dhunës së fanatikëve që sulmonin pa mëshirë përparimin e gjuhës shqipe. Babë Dudë Karbunara (1842-1917) i lindur në Berat, bashkëpunonte ngushtë me Kostandin Kristoforidhin. Babë Karbunara shumë herë filloi gjatë krenimit të meshës të lexonte ungjillin në gjuhën shqipe dhe kështu i filluan kërcënimet e para nga eprorët klerikë ortodoksë dhe më 1895, fanatikët i dogjën të tërë shtëpinë. Prifti ortodoks kapedan Stathi Melani vraponte me librat shqip në gji dhe me pushkën në krah fshat më fshat në Shqipërinë e jugut për përhapjen e shkollës shqipe dhe kishën shqiptare. Veptrimaria e Atë Stathi Melanit ra në sy të autoriteteve turke. Tri herë turku ia dogji shtëpinë dhe librat shqip, por Atë Melani nuk pyeti. Më 24 dhjetor 1917 Atë Stathi i kishin zënë pritë banda e kusarëve të Josif Surupullos, të cilët e vranë duke i prerë kokën Atë Stathi Melanit.

Petro Nini Luarasi (1865-1911) është një nga atdhetarët e shquar që punoi për përhapjen e gjuhës shqipe në rrethin e Korçës. Qe drejtor i shkollës së djemve në Korçë. Petro Nini Luarasi shkante fshati në fshat për përhapjen e gjuhës shqipe. Më 20 shtator 1892, peshkopi i Kosturit Fillateri nxori një lajmërim me titull "Mallkimi i shkronjave shqipe". Më 1909, qeveria turke mbylli të gjitha shkollat shqipe dhe dha urdhër të prerë të shuheshin në zjarr të gjitha librat, dokumentet dhe letërsia shqipe. Gjendja politike në vend në atë kohë ishte kritike për të marrë flakë nga çasti në çast. Për atdhetarët shqiptarë u bë më se nuk do t'i realizonin dot kurrë qëllimet e tyre të larta pa hapur më parë shkollat shqipe për formimin e rinisë. Deri në atë kohë rinia shqiptare kishte qenë objekt i propagandës së huaj në shkollat e hapura nga qeveria turke dhe nga kisha greke. Megjithatë, gjatë punës për krijimin e sistemit të tyre shkollor, atdhetarët shqiptarë u ndeshën me tri probleme të mëdha, pengesa nga autoritetet turke dhe greke, mungesa e të hollave dhe mungesa e mësuesve të shkolluar.

Shuma të vogla por të dobishme të hollash ishin mbledhur aty-këtu brenda vendit, kurse ato më të mëdha kishin ardhur nga shoqëritë dhe klubet shqiptare



Për të bërë të përjetshëm këtë ngjarje të rëndësishme të historisë së gjuhës shqipe, një rrugë në Kamëz është emërtuar "Kongresi i Manastirit", me propozim të kryebashkiakut Xhelal Mziu, duke marrë në mënyrë unanime miratimin e të gjithë anëtarëve të Këshillit Bashkiak të qytetit.



frenimin e arsimit në shqip. Në fund të vitit 1909, Qeveria turke ndaloi përdorimin e gjuhës shqipe me shkronja kombëtare, në të gjitha shkollat anembanë vendit. Gjithashtu, nxori një dekret, sipas të cilit gjuha shqipe do të shkruhej vetëm me shkronja arabe. Shoqëria reacionare "Mahfeti" me mbështetjen e qeverisë turke, shtypi dhe shpërndau abetaret e para me germa arabe. Për këtë arsye, në shkurt të 1910, u mbajt në Elbasan një miting proteste, ku 7000 protestues ngritën zërin kundër përdorimit të shkronjave arabe për gjuhën shqipe. Po atë muaj protestat vazhduan në Korçë, Berat, ku mbi 15.000 vetë dogjën në qendër të qytetit abetaret shqiptare me germa arabe, të dërguara nga Stambolli.

Telegrame të shumta nga shoqëritë, shqiptare të Selanikut, Shkupit e Manastirit u shprehën në mbrojtje të alfabetit shqip. Në Shkodër, një grup myslimanësh u bënë gati të organizonin një manifestim në përkrahje të shkronjave arabe. Mirëpo ndërruan mendje kur 60000 katolikë dhe myslimanë të ndershëm shqiptarë, nga Malësia e Madhe, organizuan ditë më parë një manifestim madhështor në përkrahje të shkronjave latine. Protesta të ngjashme u organizuan në Përmet, Kolonjë, Tepelenë, Frashër, Konicë etj. Por turqit nuk deshën t'ia dinin. Atëherë në mars të 1910 u thirr Kongresi i dytë i Manastirit. Aty u vendos që të vazhdojë përdorimi i alfabetit kombëtar me shkronja latine dhe protestat kundër vendimit të padrejtë të Qeverisë Turke.

Gazeta atdhetare "Shkreptima" e Kajros botoi një memorandum të hartuar nga kryengritësit që luftonin në malet e Shqipërisë. Në të theksohej se qëllimi i tyre nuk ishte për plaçkitur apo për të vrarë, por për të luftuar për "lirinë e edukimit në gjuhën shqipe dhe me alfabetin kombëtar, lirinë për të hapur të gjitha shkollat shqipe të mbyllura nga qeveria turke dhe vënien në punë të shtypshkronjave, si dhe botimin e gazetave të ndaluara, lirinë e të burgosurve politikë. Dhe përfundonte me mesazhin: "E gjithë bota e qytetëruar dhe veçanërisht qeveria e perandorisë Otomane le ta dijë mirë se t'ë gjithë shqiptarët, gegë e toskë, të krishterë e myslimanë, nuk do ta pushojnë luftën për këto tri kërkesa, derisa qeveria të na i garantojë ato me siguri".

Edhe në këtë luftë, shkolla shqipe doli fitimtare. Me pak mjete dhe mësues, por me dëshirën në shpirt për dituri shkollore shqiptare, midis pengimeve, nga armiqtë e afërm dhe të largët, shkolla shqipe fitoi nga veriu e deri në jug të Shqipërisë dhe përgatiti breza të rinj atdhedashës. Megjithëse ky zhvillim kulturor ishte përfytyruar si jo i dhunshëm, shpejt ai u kthye në një zjarr të rrezikshëm. Që shqiptarët trima si Isa Boletini dhe burri i zoti Ismail Bej Qemal Vlora, do nxitonin hapat për të shpallur mëvetësinë e Shqipërisë më 28 nëntor të 1912 në Vlorë. Pas pak muajsh filloi Lufta Ballkanike dhe Manastiri e Shkupi, dy qytete historikisht të banuara nga shumica popullsi shqiptare, u pushtuan nga sllavët. Të gjitha dyqanet dhe librat shqip u dogjën dhe shumica e atdhetarëve shqiptar u therën nga serbët, disa u burgosën. Popullata myslimane shqiptare u detyrua të braktiste qytetin e Shkupit dhe të Manastirit, ato familje ortodokse shqiptare që mbetën aty, me kalimin e viteve dhe me dhunë u nënshtruan duke humbur dinjitetin e tyre shqiptar.

(Burimi: **Wikipedia**)



Realizohet një tjetër projekt për banorët e Paskuqanit, rruga “Ismail Qemali”

Nentor 2017
GAZETA KAMZA

7

Në këtë mënyrë, kryebashkiaku Xhelal Mziu realizon një tjetër premtim, një tjetër projekt për banorët e zonës, rrugën “Ismail Qemali”, pjesë e një investimi madhor që përfshin edhe rrugët “Ejll Deda” dhe “Isuf Xhelili”

Ndryshimi në infrastrukturën rrugore vërehet në çdo lagje të Paskuqanit. Pjesë e këtij ndryshimi rrënjësor është edhe ndërtimi i rrugës “Ismail Qemali” në lagjen Paskuqan 2. Në këtë mënyrë, kryebashkiaku Xhelal Mziu realizon një tjetër premtim, një tjetër projekt për banorët e zonës, rrugën “Ismail Qemali”, pjesë e një investimi madhor që përfshin edhe rrugët “Ejll Deda” dhe “Isuf Xhelili”.

I gjithë investimi, me gjatësi më shumë se 1 km, është i financuar tërësisht nga buxheti i Bashkisë, duke qenë se për qeverinë aktuale “nuk ekziston” qyteti, Bashkia dhe qytetarët e Kamzës. Ndërtimi i këtyre rrugëve përbën një prej momenteve më të rëndësishme



të krijimit të një infrastrukture bashkëkohore në zonën e Paskuqanit, gjë e cila ka munguar deri tani.

Ky është edhe angazhimi kryesor i kryebashkiakut Xhelal Mziu, gjithashtu dhe një premtim i realizuar tashmë. Edhe pse me shumë vështirësi, për shkak të mosfinancimit të asnjë projekti nga qeveria, Bashkia po bën realitet synimet e saj për një ndërhyrje themelore në infrastrukturën urbane të Paskuqanit.

Ndërtimi i rrugëve “Ejll Deda”, “Ismail Qemali” dhe “Isuf Xhelili” krijon lehtësi në lëvizjen e qytetarëve dhe automjeteve, duke ndikuar edhe në zhvillimin e aktiviteteve private përgjatë këtyre segmenteve rrugore.

Kryebashkiaku Mziu inspekton një ndër investimet e vitit 2017, rrugën “Ajet Xhindoli” në lagjen Paskuqan 2, Vresht



Vazhdojnë të zbatohen të gjitha investimet e planifikuara për vitin 2017 në territorin e Bashkisë Kamëz. Të gjitha investimet në këtë territor janë totalisht nga buxheti i planifikuar në fillim të vitit 2017 nga kjo Bashki. Inspektimi i radhës i kryebashkiakut Xhelal Mziu përkon me një nga investimet në infrastrukturë në Njësinë Administrative Paskuqan dhe konkretisht në lagjen Paskuqan 2, Vresht. Segmenti rrugor “Ajet Xhindoli”, me një gjatësi 480 ml dhe me bazë 4ml, sjell një impakt për rreth 500 familje, duke ndryshuar totalisht formacionin infrastrukturor, duke e kthyer nga një rrugë rurale në një strukturë urbane. Zhvillimi i infrastrukturës në çdo cep të territorit të Bashkisë Kamëz sjell qartësisht në memorien e qytetarëve të Kamzës vizionin e kryebashkiakut Mziu për të ndryshuar me çdo buxhet të llogaritur ndër vite infrastrukturën rrugore, por edhe të gjithë spektrin urbanistik me ndikim të drejtpërdrejtë në ambient dhe shëndetin e qytetarëve të Kamzës. Përgjatë inspektimit të asfaltimit të këtij segmenti rrugor, kryebashkiaku Mziu kërkoi edhe një herë nga investitori respektimin e të gjithë parametrevë të projektit si dhe zbatimin korrekt i tij në respekt të miratimit të investimit. Banorët e pranishëm në këtë investim falënderuan përzemësisht z. Mziu për punën e shkëlqyer që ka bërë në Kamëz në këto vite, por edhe atë që vazhdon të kryejë edhe në Paskuqan.

Investimet në Paskuqan, më të mëdha se në 27 vitet e fundit

Bashkia Kamëz ka pasur dhe ka prioritet të saj përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës rrugore dhe KUN dhe dy vitet e fundit në fokus ka qenë veçanërisht Paskuqani.

Investimet e bëra në këtë njësi administrative janë më të mëdha se në 27 vitet e fundit.

Gjithsesi, më shumë se fjalët, puna flet vetë dhe këtë e shohin jo vetëm banorët e Paskuqanit dhe të Kamzës, por edhe të gjithë ata qytetarë që kanë kaluar këto vite qoftë një herë në territorin e Bashkisë Kamëz.

Jo më kot, qysh me ndërtimin e rrugës kryesore



të Paskuqanit, rruga “Demokracia” e gjatë 7 km, rreth 40% e trafikut të kryeqytetit kalon në këtë segment.

Mbi 250 km rrugë janë asfaltuar gjatë drejtimit të Bashkisë Kamëz nga kryebashkiaku Xhelal Mziu, edhe kur për katër vite me radhë nuk mori asnjë financim nga qeveria e majtë.

Në dy vitet e fundit, në Njësinë Administrative të Paskuqanit kanë shkuar rreth 60% të investimeve të Bashkisë Kamëz.

Vetëm këtë vit, nga 60 projekte infrastrukturorë, shumica dërrmuese e tyre u zbatua dhe po zbatohet në lagjet e Paskuqanit, mes tyre edhe një rrugë e rëndësishme në Babrru-Shpat, mbi 1 km e gjatë, e cila shërben edhe si një unazë në këtë zonë, investim që për herë të parë e shohin banorët e këtyre lagjeve.

Ndërkaq, në buxhetin e vitit 2018 parashikohet të financohen më shumë projekte në infrastrukturën rrugore të Paskuqanit.

Vijon urbanizimi i Paskuqanit, me ndërtimin e rrugës “Ymer Haxhi Prizreni” në Babrru-Shpat



Vijon urbanizimi i Njësisë Administrative të Paskuqanit me ritëm të shpejtë. Është rruga “Ymer Haxhi Prizreni”, pjesë e unazës në Babrru-Shpat, që është ndërtuar vetëm me të ardhurat e Bashkisë Kamëz.

Ka qenë kryebashkiaku Xhelal Mziu që ka inspektuar punimet. Rreth 1 km është gjatësia e këtij segmenti rrugor, ku ka investuar këtë vit Bashkia Kamëz ndërmjet shumë investimeve të tjera.

Kjo rrugë ndodhet në lagjen Babrru-Shpat të Njësisë Administrative të Paskuqanit.

Për realizimin e këtij investimi Bashkia Kamëz pati ndërmarrë edhe një aksion për lirimin e hapësirave publike përgjatë saj. Në 1050 ml të gjatësisë së kësaj rruge, parametrat do të jenë bashkëkohorë, me qëllimin për të ofruar një infrastrukturë të një standardi të lartë për banorët e kësaj zone.

Duhet thënë se zbatimi i projektit për ndërtimin e rrugës “Ymer Haxhi Prizreni” sjell një ndikim të madh social të qytetarët, pasi përmirëson ndjeshëm kushtet në të cilat ndodhej kjo rrugë, duke sjellë kështu lehtësinë e lëvizjes, si të këmbësorëve ashtu edhe të automjeteve.



Bashkia dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu vazhdojnë mbështetjen e plotë ndaj ekipit KF Kamza

Bashkia Kamzë dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu vazhdojnë të mbështesin ekipin KF Kamza, duke qenë një mbështetëse e drejtpërdrejtë e ekipit të futbollit edhe financiarisht. Edhe pse tri ekipe në ligën superiore kanë aksione të përbashkëta me bashkitë, si Kamza, Shkodra dhe Lushnja, në kanalet televizive të "Supersport"-it po flitet vazhdimisht që edhe qeverisjet vendore mund të jenë mbështetëse dinjitoze të sportit dhe veçanërisht të futbollit.

I tillë është titulluar edhe ekipi i futbollit Kamza që, edhe pse erdhi në Superligë si një ekip i vogël, tashmë ai e sheh veten pretendente kryesore për pjesëmarrje në kupat e Evropës.

Analistët sportivë vlerësojnë shumë rolin e Bashkisë dhe veçanërisht të kryebashkiakut Mziu për interesimin e vazhdueshëm për futbollin dhe në tërësi ekipin për të ruajtur ritmin, marrjen e rezultateve pozitive, pse jo, edhe pjesëmarrjen në kupat e Evropës.

Kryebashkiaku Mziu në takimin e radhës me stafin drejtues ka kërkuar të shohë më tej për të frymëzuar çdo futbollist për të dhënë maksimumin për vlerat që ekipi i Kamzës ka treguar dhe po tregon. Nga ana e tij, z. Mziu nuk ngurroi të jepte mbështetjen financiare për KF Kamzën.

FK Kamza: Arbitri na vodhi fitoren e merituar, i njëjti që gjykoj edhe në Kukës, këmbana bie për FSHF-në

I njëjti arbitër në të dyja ndeshjet është i qëllimshëm apo rastësi!? Edhe në ndeshjen me Flamurtarin arbitri i mohoi Kamzës golin e rregullt dhe penalltinë të saktë të padhënë

Këtë sezon FK Kamza po luan futboll të bukur, por në disa ndeshje vijnë që arbitrat ta dënojnë padrejtësisht dhe t'i mohojnë fitoret. Rastet janë konkrete, si gjykimi në përballjen dy herë me Kukësin si dhe ndaj Flamurtarit të Vlorës. Në ndeshjen me Kukësin, Kamza e dominoi totalisht kundërshtarin në çdo drejtim, por arbitri Kridens Meta i mohoi fitoren e merituar. Goli i parë i Kukësit ishte faull i dukshëm ndaj portierit të Kamzës, Argent Halilaj,

nga sulmuesi i Kukësit Kale, por arbitri, në vend që ta anulonte, e akordoi si gol të rregullt. Është i njëjti arbitër që ka gjykuar edhe ndeshjen e parë të fazës së parë në Kukës, ku e ka favorizuar qartë Kukësin edhe në takimin e parë. I njëjti arbitër në të dyja ndeshjet është i qëllimshëm apo rastësi!? Edhe në takimin e fazës së dytë, i njëjti arbitër me të njëjtin mision, të dënonte ekipin e Kamzës. Kujtojmë që ekipit të Kamzës i kanë mohuar fitoren edhe në ndeshjet e tjera të luajtura, pavarësisht nga futbollit i bukur i zhvilluar. Në transfertën në Vlorë ndaj Flamurtarit, edhe pse Kamza luajti një ndeshje të bukur, arbitri i mohoi fitoren, ku i anuloi një gol të rregullt sulmuesit të Kamzës, Fukui, dhe i mohoi

një penallti të sigurt ekipit të Kamzës në minutën e 95-të. Në pamjet filmike duket qartë se kishim të bënim me një 11-metërsh të mohuar në favor të Kamzës, i cili mund të ishte vendimtar në rezultatin final të takimit. Në analizën e moviolës që specialistët e futbollit i bënë ndeshjes së Kamzës, u tha që këtë ekip vijnë ta dënojnë arbitrat, duke i mohuar edhe fitoren. Në total, Kamzës i janë mohuar 6 pikë të sigurta. Me pikët e mohuara, Kamza do të renditej në vendin e dytë të tabelës së klasifikimit. Këto raste prekin drejtpërdrejt FSHF-në, pasi gjykimi ka qenë i kontestuar në disa ndeshje dhe po bëhen shumë klube që ngrenë zërin këtë herë për menaxhim aspak serioz të garës dhe favorizim të disa ekipeve.



Kamza, një "supermaci" ndaj Skënderbeut



Vazhdon paraqitja e shkëlqyer e ekipit të futbollit Kamza në Superligë. Jo vetëm e barabartë, por me një rezultat pozitiv e mbylli takimin e javës së 11-të, e cila në kalendarin e saj paraqitej si kryendeshja. Në pamjen e parë dhe në mbarë opinionin analitik, parashikohej një takim i cili do të përfundonte me fitoren e ekipit të Skënderbeut, i cili po përgatitej për të marrë një fitore, e cila do t'i motivonte futbollistët korçarë për të pasur një takim premtues dhe marrjen e një rezultati mjaft pozitiv në takimin e radhës me Dinamon e Kievit në kuadrin e ndeshjeve të Europa League, që do të zhvillonte më pas. Ekipi i Kamzës tregoi edhe një herë që vlerëson çdo përballje pa nënvlerësuar dhe mbivlerësuar ekipet përballë, por premtonte që do të jetë një ekip ambicioz për të marrë maksimumin e rezultateve dhe duke qenë një ekip pretendent për kampionatin shqiptar. Edhe pse trajneri i ekipit korçar pati paralajmëruar: "Kujdes Kamzën, s'mund të gabojmë sërish", përsëri takimi u zhvillua i barabartë, gjë që provoi që dhe rezultati ishte i barabartë. Vijnë edhe vëmendja dhe mbështetja e drejtuesve të klubit të futbollit Kamza, por veçanërisht e kryebashkiakut Xhelal Mziu, i cili të ndjek dhe kërkon nga çdo ndeshje rezultatin pozitiv.

Zhvillohet festivali i shkollave 9-vjeçare të qytetit në Pallatin e Kulturës Kamzë



Është në Pallatin e Kulturës Kamzë edicioni i pestë i festivalit të ansambleve të shkollave 9-vjeçare të qytetit. Në këtë aktivitet kulturor konkurronin 22 shkolla 9-vjeçare, të cilat përcollën për të pranishmit shfaqje argëtuese me karaktere të ndryshme, duke shpalosur talentet e fëmijëve të këtyre shkollave. Ky aktivitet, i cili u mbajt për 5 ditë me radhë, nga data 20.11.2017 deri më datë 24.11.2017 në ambientet e Pallatit të Kulturës, u zhvillua me rastin e festave të nëntorit. Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e Bashkisë Kamzë dhe Zyrës Arsimore. Festivali është një risi për të gjithë fëmijët, por edhe prindërit, të cilët tashmë gjejnë mundësitë që në ambientet e Pallatit të Kulturës në Kamzë të shohin dhe të ndjekin nga afër talentin e fëmijëve të tyre. Nga kjo pikëpamje, kryebashkiaku Xhelal Mziu ka ofruar gjithashtu bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm në jetën e qytetit të Kamzës për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës qytetare, pse jo, edhe me argëtimet që ofrojnë ambientet e këtij Pallati Kulture. Në përfundim të festivalit, juria vlerësoi me çmime shkollat "Ibrahim Basha", "Azem Hajdari", "Halit Coka", "Tahir Sinani", "Hillary Clinton", "Kamza e Re", "Nënë Tereza", "Jashar Hoxha", "Vëllazërimi", si dhe një numër të madh artistësh të shkollave.

Bashkia Kamzë nëpërmjet instrumenteve të saj po zhvillon të gjitha politikat mbështetëse për rritjen e talenteve të reja, duke u ofruar kushte dhe infrastrukturë të përshtatshme. Mbështetja e këtij aktiviteti u bë drejtpërdrejt nën kujdesin e kryebashkiakut Xhelal Mziu, i cili vazhdon të promovojë vizionin e tij jo vetëm ndaj investimeve dhe shërbimeve ndaj qytetit të Kamzës, por edhe një mbështetës i vazhdueshëm i kulturës, artit dhe sportit.

6 medalje për Kamza Karate në turneun ndërkombëtar të Tivarit në Mal të Zi



Kamza Karate vijon të triumfojë duke u kurorëzuar me trofe në çdo aktivitet kombëtar dhe ndërkombëtar. Në turneun ndërkombëtar "Tivari Open", ekipi i Kamzës në karate fitoi 6 medalje. Ishte një aktivitet i përmasave të mëdha, ku morën pjesë 7 shtete me 940 sportistë. Kamza në këtë aktivitet u përfaqësua me 6 sportistë. Gjithashtu, Kamza Karate mori pjesë edhe në turneun tjetër ndërkombëtar "Adem Jashari" për të gjitha grupmoshat që u zhvillua në Prishtinë. Kamza u përfaqësua me 4 sportistë, ku vlen të përmendet sportisti Ernik Pjetri, i cili zuri vendin e parë. Ekipi në turneun ndërkombëtar "Tivari Open" u shoqërua nga Kastriot Pjetri, asistent trajner, dhe nga Luftar Kurti, gjyqtar. Në të dy turnetë ndërkombëtarë pritshmëritë ishin të mëdha për ekipin e Kamzës.